



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 22 maj 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Muharrem Nitaj, Andin Hoti, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Faton Topalli, Albert Kinolli dhe Ali Lajçi.

Munguan: Zafir Berisha dhe Verica Çeraniq.

Stafi Mbështetës: Mehmet Simnica dhe Ajet Avdullahu.

Pjesëmarrësit tjerë: Hysa Matoshi, Driton Gjombala, Xhelil Bekteshi, Shqipe Krasniqi-Selishta nga AAC-ja; Vlora Spanca, Emina Fazliu, Ramadan Gashi, Fexhrie Thaqi nga ZKA-ja; Dhurata Kryeziu nga OSBE-ja; Blerim Dina, Agim Sheqiri nga OSHP-ja; Mahir Yagcilar dhe Kujtim Gashi nga MAP-i.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 02.05.2018 dhe 16.05.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017;
4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017;
5. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Performcës për “Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria”;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 02.05.2018 dhe 16.05.2018;

Përfundimi

Procesverbalet e mbledhjeve, të mbajtura më 02.05.2018 dhe 16.05.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017

Kryetari njoftoi se në cilësinë e raportuesit për shqyrtimin e raportit të Auditimit për PVF-të e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017 është Deputeti Mërgim Lushtaku dhe ftoi për ta prezantuar raportin dhe të gjeturat nga raporti.

Mërgim Lushtaku, paraqiti në detaje të gjeturat e raportit të Auditimit për Autoritetin e Aviacionit Civil, në raportin e ekzekutimit të buxhetit, kolona e buxhetit final është prezantuar në vlerë 873,763€ në PVF, ndërsa sipas SIMFK-së buxheti final është 892,327€. Kemi një nënvlerësim prej 18,564€; ndërsa raporti për fondet e donatorëve të pashpenzuara nuk ishte shpalosur, ndërsa sipas SIMFK-së vlera e pashpenzuar e donacioneve është 4,694€. Dhe po ashtu tha se disa nga të metat e raporti vjetor janë menaxhimi jo i duhur i personelit dhe sistemi i auditimit të brendshëm. Sistemi i auditimit të brendshëm nuk ka qenë i kompletuar. Kemi vërejtur që nuk ka të bashkangjitur një pasqyrë financiare vjetore, dhe ZKA duhet të japë rekomandime dhe të dhëna për menaxhimin e personelit. Të angazhohet departamenti i auditimit që të bëjnë auditimit e brendshëm të këtij institucioni për vitin 2017. Po ashtu parashtrij shumë pyetje për përfaqësuesit e AAC-së. Dhe në fund paraqiti disa konkluzione të përgatitura.

Faton Topalli theksoi se prej që jam anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen të Financave Publike nuk ka pasur një raport kaq të mirë se sa ky dhe ju përgëzoj për punën që keni bërë dhe që vazhdoni ta bëni. Po ashtu pyeti se a është marrë ndonjë gjobë apo kallëzim penal për operatorin që ka gënjyer për qëllimin e fluturimit. Përmendi çështjen e tarifave të larta të biletave, dhe që ne paguajmë çmimin më të lart të biletave? Cilat janë pritjet e AAC-së në këtë drejtim?

Emine Fazliu tha se AAC-ja sa i përket pushimeve të lehonisë dhe rekrutimit që nuk ka pasur rezultat në raport, sipas saj, kjo është çështje e brendshme e AAC-së. Sa i përket sistemit të auditimit të brendshëm ajo tha se AAC-ja nuk përmbush kriteret për të pasur auditorë të brendshëm. Sipas raportit, AAC në fundit ka dalë me një kursim 30 mijë euro në kuadër të pagave dhe mëditjeve, kjo ka ndodhur që dy zyrtarë kanë dhënë dorëheqje, dhe nuk ka pasur rekrutim të stafit të ri.

Shqipe Pantina, sa i përket raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit nuk kam ndonjë vërejtje, mendojë që AAC-ja do duhej të bënte diçka më shumë që të kontrollohet hapësira ajrore e Kosovës,

çfarë mundëm të bëjmë ne, si Kuvend, që t'ju ndihmojmë në rritjen e kapaciteteve tuaja që vija ajrore të kontrollohet nga AAC-ja, sepse dihet që një shumë të caktuar të mjeteve humb Kosova, nga kjo?

Kryetari pyeti se cila është gjendja në rastin e operimit të avioni që mori shtetasit turq dhe i largoi? Kush është kompetent për të verifikuar se a po realizohet ai fluturim ne bazë të kërkesës për një fluturim komercial? Apo është keqpërdore leja e fluturimit? Ishin disa nga pyetje e ngritura.

Muharrem Nitaj pyeti a jeni krejtësisht të përjashtuar si Autoritet i Aviacionit Civil nga inpakti në fluturime, qofshin ato komerciale apo të tjera, sepse dihet se hapësira ajrore e Kosovës kontrollohet nga NATO. Cila është mënyra për të bërë verifikimin e dokumentacionit për leje për operim, a mund të jepet një fluturim çfarë do natyrë të jetë ai të ketë lejen për fluturim komercial?

Avdullah Hoti theksoj se ne jemi në procedurë brenda Kuvendit për themelimin e një komisioni hetimor parlamentar për këtë çështje, të dëbimit të 6 shtetasve turq nga Kosova, pra ju po konfirmoni që lidhja ajrore ka qenë me kërkesë të një fluturimi komercial dhe tjetra është që udhëtarët që janë bartë nga ky avion për qellim komercial, nuk kanë kaluar nëpër kontrole e zakonshme të detyruar si të gjithë udhëtarët që kalojnë nëpër linjat komerciale.

Driton Gjombala, drejtor në Autoritetit të Aviacionit Civil, theksoi se ne këtu po shqyrtojmë raportin e auditimit të PVF-ve për vitin 2017. Por meqenëse kemi pyetje edhe jashtë kësaj po mundohem ne pika të shkurtra të përgjigjem në pyetje e juaja. Ai tha se lejet e fluturimit janë në përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës. Është përgjegjësi e MI-së, si hisedar dhe kolegë që punojmë bashkë, e ne e dimë se kërkesa për fluturim është bërë në MI si fluturim komercial, kompania ka gënjyer për qëllimin e fluturimit. Çfarë ka ndodhur në ndërkohë është duke u hetuar. AAC për shkak se nuk është kompetencë e saj nuk ka qenë e përfshirë direkt në këtë proces, tha se nëse miratohet fluturimi komercial AAC bën vetëm kontrollin teknik të aeroplanit, duke shtuar se asnjë pasagjer nuk mund të hyjë në aeroplan pa u kontrolluar së fundi nga Policia e Kosovës. Nëse miratohet fluturimi komercial, AAC bën kontrollin teknik të aeroplanit. Përderisa asnjë pasagjer nuk mund të hyjë në aeroplan pa kaluar, PK-ja është autoriteti final që i kontrollon të dhënat e udhëtarëve për me qenë pasagjer në atë aeroplan, nuk e di që mund të ketë mekanizëm tjetër për të kaluar deri në aeroplan. Theksoj se MI është duke u marrë me këtë çështje, por se mund të vendoset gjoba deri 1 milion euro për atë operatorë dhe të merren masa të tjera, MI është duke bërë punë të madhe në të gjitha rrethanat që ka marrë të dhëna, mund të vendos gjoba deri 1 milion euro. Autoritetet kompetente me përpikëri janë duke vazhduar punën e vet deri në përfundimin e këtij rasti, Ndërsa tha se te menaxhimi i personelit te rekrutimet dhe pushimet e lehonisë ka qenë një auditim i suksesshëm. Ne, si Agjenci, e kemi dorëzuar raportin në Kuvend dhe deri tash ai është dashur t'ju shpërndahet deputetëve. Tek Menaxhimi i personelit me rekrutimet dhe pushimet e lehonisë, kemi pas një auditim të suksesshëm dhe me krenari mund t'ju themi se nuk ka pasur asnjë gjetje.

Përfundim

KMFP, vendosi që raporti i Auditimit për PVF-të e Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2017, të mos adresohet për seancë plenare, ndërsa rekomandimet të dhëna do të miratohen në mbledhjet e radhës së KMFP-së.

4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017

Kryetari njoftoi deputetët dhe të pranishmit se raportues për këtë Institucion është Deputeti Andin Hoti, me këtë hapi diskutimin.

Andin Hoti - Ky raport ka të bëjë me auditimin e rregullsisë, i cili është i obligueshëm me ligj, dhe përmbledh çështjet e dala nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit nëse PVF kanë prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Për PVF-të e OSHP-së për vitin 2017 ZKA ka dhënë Opinion të Pamodifikuar. Sipas opinionit të ZKA-së Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore. Në vitin 2017, OSHP ka shpenzuar 292,014€ apo 89% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 10% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm. OSHP-ja realizon të hyra nga konfiskimet e depozitave të operatorëve ekonomik të cilave ju referohen ankesat si të pa pabazuara me vendime të paneleve shqyrtuese, të njëjtat pastaj kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Këto të hyra në 2017 ishin në vlerë prej 37,231€, krahasuar me vitin e kaluar kemi një rënie në inkasimin për rreth 68%.

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 7,946€. Në përgjithësi OSHP ka kontrollë të mira në menaxhimin e obligimeve. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Raporti ynë i auditimit për PVF të vitit 2016, ka rezultuar me 12 (dymbëdhjetë) rekomandime. OSHP kishte përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit për PVF për vitin 2016 të ZKA, ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, 5 (pesë) rekomandime janë zbatuar, 4 (katër) janë në proces ndërsa 3 (tre) nuk janë adresuar ende. Për më tepër, nga viti 2015 ishin bartur edhe 4 (katër) rekomandime, 1 (një) i pa zbatuar dhe 3 (tre) të tjera ishin në zbatim e sipër. Dhe në fund propozoi që ky raport nuk ka nevojë të adresohet për në seancë plenare, megjithatë KMFP duhet të obligon OSHP-në për të përgatitur planin e veprimit për adresim të rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit.

Blerim Dina njoftoi deputetët për angazhimet që ka bërë OSHP-ja në shqyrtimin e lëndëve të ardhura nga autoritetet kontraktuese, si dhe nga operatorët ekonomik.

Muharrem Nitaj theksoi se opinionet e dhëna për PVF-të e OSHP-së janë me opinion të mirë, andaj besoi se Auditorët kanë bërë një vlerësim real.

Përfundim

KMFP, vendosi që raporti i Auditimit për PVF-të e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për vitin 2017, të mos adresohet për seancë plenare, ndërsa rekomandimet të dhëna do të miratohen në mbledhjet e radhës së KMFP-së.

5. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Përformancës për Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit -Pasuria

Kryetari njoftoi të pranishmit se raportues për raportit të Auditimit të Performancës për Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit e-Pasuria është deputeti Avdulla Hoti. Me këtë hapi diskutimin.

Avdullah Hoti- Ky raport ka të bëjë me auditimin e performancës. Ky auditim është iniciuar në bazë të marrëveshjes në mes të ZKA dhe DEMOS. Qëllimi i auditimit ishte vlerësimi i menaxhimit të aplikacionit -Pasuria nga Ministria e Administratës Publike, përkatësisht Agjencia e Shoqërisë së Informacionit dhe shfrytëzimi i saj nga të gjitha organizatat buxhetore përgjegjëse për ruajtjen e pasurisë publike. Në këtë audituar MAP përkatësisht ASHI, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komunën e Ferizajt, Komunën e Lipjanit, Doganat e Kosovës dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ky auditim ka mbuluar periudhën nga fillimi i projektit viti 2010 deri në shtator 2017. MAP-ia është përgjegjës për menaxhimin e këtij aplikacioni, ndërsa organizatat tjera buxhetore janë përgjegjëse për regjistrimin e e-Pasurisë në këtë aplikacion, të gjeturat kryesore të këtij auditimit janë ndarë rolet dhe përgjegjësitë, por nuk ka është vendosur as bashkëpunimi i MF dhe MAP në raport me mënyrën e zbatimit e rregullores së MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Nuk është e cekur se cili është roli i MAP përkatësisht ASHI lidhur me mënyrën e menaxhimit dhe monitorimit të pasurisë ndërsa nga zyrtarët përgjegjës kemi kuptuar se nuk kanë asnjë bashkëpunim në praktikë. Tjetra është që mungojnë procedurat të monitorimit dhe kontrollimit të sistemit, veçanti për masat mbrojtjes të sistemit, posaçërisht në rastet e rimëkëmbjen e sistemit kur ka fatkeqësi ose raste të jashtëzakonshme. Tjetra është që aplikacioni afron një qasje gati të pa penguar të përdoruesve në aplikacion, nga auditimi është gjetur që janë 800 përdorues të pa identifikueshëm dhe një pjesë e moduleve nuk janë zhvilluar as ai i buxhetit qysh janë paraparë me kontratë që nga viti 2010. Te trajnimi për përdorimin të këtij aplikacionit duket që nuk ka një trajnim sistematik të zyrtarëve për përdorimin e këtij aplikacioni dhe kjo vërtetohet me përdorimin e një numri shumë të vogël të organizatave buxhetore. E gjetura tjetër është që nuk ka vetë agjencia që nuk përdoren të gjitha aplikacionet dhe ma problematike është që sistemi nuk lejon me verifikua çfarëdo ndryshimi që ndodh në sistem, pra mund fshihen transaksione ose regjistrimet e pasurisë dhe nuk ka ndonjë evidencë çka është shtuar dhe çka është heq.

Mahir Yagcilar theksoi se ky sistem daton që nga viti 2009, mendoi se është bërë progres, megjithatë ende ka sfida. Defektet në sistem janë me tepër nga ajo se Institucionet nuk po menaxhojnë mirë me sistemin sesa dobësi e vetë sistemit.

Kujtim Gashi, theksoi po ashtu se ky sistem ju ka mundësuar Institucioneve të kenë një pasqyrë reale mbi gjendjen e stoqeve, problemi qëndron në atë se një numër i Institucioneve nuk i rifreskojnë të dhënat në sistem. Problemi me përdorues jo të vërtetë është duke u eliminuar nga ana e MAP-it, edhe pse ata nuk kanë mundur të kyçen në sistem për të ndryshuar të dhënat.

Faton Topalli theksoi se vite të tëra ka pasur mos koordinim në mes MAP dhe MF për sa i përket sistemit të regjistrimit të pasurisë së Institucioneve. Mendoi se këtu nuk është problemi te përdoruesit por problemi qëndron te vetë sistemet, duke arritur të krijon sisteme paralele, duke gjeneruara të dhëna të kundërta.

Përfundim

KMFP, vendosi që raporti i Auditimit të performancës për Menaxhimi dhe shfrytëzueshmëria e aplikacionit -Pasuria, të mos adresohet për seancë plenare, ndërsa rekomandimet të dhëna do të miratohen në mbledhjet e radhës së KMFP-së.

6. Të ndryshme;

Kryetari, njoftoi deputetët se deri tani kemi pranuar 18 raporte të auditimit të PVF-ve si dhe raporte të performances. Propozoi që në mbledhjen e radhës së komisionit të nxirren rekomandimet për AAC, OSHP dhe për -Pasuri, ndërsa është mirë që në mbledhjen e radhës së komisionit të shqyrtohet raporti i auditimit për performancën e Hortikultura SH.A. për vitin 2017.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i Auditimit të performancën e Hortikultura SH.A. për vitin 2017, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj